

BIBLIOTEKA
SHTETIT

ESH-1
C13

TUANE

TE

BARDHA

VJERSHA DHE POEMA

ALEKS
ÇAÇI

834-1
C 13

ALEKS ÇAÇI

FJALË TË BARDHA

Vjersha dhe poema



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

1941

(Poemë)

Dhoma ish e vogël.
Strukeshim përdhë, vinim grushtin për jastëk,
gjumi na zinte, dhe na dukej sikur
ngrinim flamuj të kuq në qiell,
sikur, bashkë me në,
shokët e gjithë botës,
na shtrëngonin dorën, na puthnin,
shokë të panjohur,
sikur bashkë me ta ndanim
atë copë bukë misri,
shpresat, të ardhmer,
çdo gjë ndanim,
një unë, një ti, një unë, një ti.

E nisëm pak këtë udhë.
Ishim pak, shumë pak.
Po ishim shumë, se ishim popull.
Flaka e atyre ditëve
ndriçoi fytyrat e të gjithëve.
Një zë i rëndë kumboi:
fashistë dhe borgjezë, dridhuni!
Si? Ata nuk dinin nga të shkonin.
Nga mbiu gjithë kjo fuqi?
Nga shpërtheu gjithë ky vullkan?
Pemët lëshuan gjethe në Nëndor.
Nata ish e gjatë,
mëngjezi do të vononte shumë.
Po do të vinte mëngjezi,
(këtë herë, ish nata e fundit.)

Shok, shok, shok...
Si u mbush gjithë Atdheu me këtë fjalë?
Fjalë e re, e ngrohtë, me shpresa shumë...
Në këtë fjalë
mbyllej një çelës i madh
që do t'i hapte të gjitha dyert,
— dyert e dritave të mëdha,
e këngëve,
e punës që do të bëhej dëfrim,
e syve që do të këndonin,
fjalë që s'ishte dëgjuar ndonjëherë,

e heroizmit që, mbi të gjitha,
vinte gëzimin e të tjerëve,
bukën e të tjerëve,
të ardhmen e të tjerëve...

Natë. Jashtë frynte erë.
Njerëzit luftonin me natën.
Qe natë e madhe, e pambaruar,
një natë e bukur,
që ruante ëndërrat më të bukura të botës,
që lëshoi një zë,
një zë, që zgjoi ëndërrat shekullore të të
parëve.

Për herë të parë flisnin të varfërit,
të shtypurit,
për herë të parë u drodhën borgjezët.
Dëgjoni: Flet revolucionin!
Flet djersa e derdhur për të tjerët.
Flet me urrejtje ai që u dergj nëpër burgje,
që i pikoi gjak në zemër,
që la nënë e babë në mes të rrugëve
për revolucionin.

Dëgjoni. Flet revolucionin.
Për botën pa brenge e dhembje,
për një zemër të bardhë,
për një fjalë të drejtë,

për popullin — pa borgjezët,
spiunët, vrasësit, kopukët, tradhëtarët, —
për fjalët e fundit që thanë ata që u varën,
për ata që u vranë për një copë bukë të zezë,
për ata që ranë
dhe thanë — rroftë revolucion!

Shtëpia e vogël u rrit.
Partia hodhi rrënjë
dhe, në agim,
dera u hap.
Dolën fjalët. Dëgjoni: Rroftë revolucion!
Këto fjalë u përleshën me fjalët të tjera, —
tradhëti, pajtim me armikun,
dyshim, djallëzi, —
u përleshën dhe fituan.
Dy fjalë fituan. Rroftë revolucion.
Njerëzit filluan atë ditë
të ecin me hap të sigurtë.

Shok, shok, shok...
Si u mbush gjithë Atdheu me këtë fjalë?
Një betim i madh:
T'i bëjmë të tjerët, të këndojnë,
t'i bëjmë të tjerët të lumtur,
të jetojnë të tjerët,
ne, edhe sikur të vdesim,
do të bëhemi rreze të zjarra

që do të ndriçojnë
sytë e t'uriturve për dritë.
Borgjezët do ta paguajnë shtrënjtë,
ata që në shekuj na kanë shfrytëzuar,
që pinë gjakun e prindërve tanë,
të gjyshërve, stërgjyshërve,
të të parëve tanë. . .

U dëgjuan pushkë. Ato ishin shpresa.
Po nganjëherë pushka vriste.
U vra marangozi. E qëlluan në ballë,
ai foli «rroftë komunizmi».
Tjetrin e varën. Po fjalët s'i varën.
Ecën fjalët, u vunë flakë zemrave.
Nëna doli në rrugë me nallane,
të kërkonte të birin. Ia prunë të vrarë.
E njeh? i thanë, biri yt?
— Jo, tha nëna. Është biri i popullit.
Xhelatët shtangën. U trëmbën, nënën kur
e panë.

Gjithë natën priti nëna
në pezulin e shtëpisë.
Natë. Ca yje të vegjël ishin në qiell.
Ajo priti. Priti dhe priti:
— Ku të jetë vallë?
Mezi e rrita, duke larë rroba në dyert
e botës.

Ku të jetë vallë? —
Ajo nuk flë. Gjumi sonte nuk të vjen, o nënë.

Komunizmi foli dhe në e dëgjuam.
Ndënjëm gjithë natën.
Ne nuk do të vdesim. Po edhe të vdesim,
nuk vdes e drejta, liria, dashuria,
nuk vdesin të tjerët.
Nuk vdesim, që të rrojnë të tjerët,
që të qeshin të tjerët.

Qeshnim fshehurazi, —
sa bukur qeshnim!
Në shtëpinë e ulët
të qeshësh kur vendi yt është shkelur,
kur zemrat janë djegur për liri,
kur zjen kudo urrejtje dhe hakmarrje,
kur sheh larg ditët e bukura që do të vijnë, —
ja, kjo ishte një e qeshur e rrallë,
kështu qeshin vetëm komunistët.

Çelën pemët e para.
Lulet e para ishin të kuqe.
Kalonim, i shikonim...
Kur do t'i shikojmë e të ngopemi?

Tirana nuk lodhet.

E plagosur, vazhdon të qëllojë, të qëllojë...
A mund ta mposhtin Tiranën fashistët?
Vdekja vjen rrotull, — kërkon:
ku janë komunistët?

Marangozi me opingat e grisura,
që hyn e del natën në dhomën time të errët,
me duart plot me shpresa,
me mall për jetën,
e me urrejtje për borgjezët
që flënë të ngopur dhe ngrihen të ngopur,
më puthi fort në buzë...
Unë akoma e kam të ngrohtë buzën
nga e puthura e marangozit
që i ka mbetur vetëm kujtimi,
në një qoshe të zëmrës sime të plagosur.

Unë flë në bodrum.
Aty nuk ka ditë.
Nëna dhe babai s'dinë kur gdhin,
nuk dinë kur vjen nata.
Sipër nesh, dritare të hapura,
perde tyli të bardha
vazo me lule
dhe, brenda në dhomat e ajrosura,
borgjezët thërrasin,
që të dëgjojmë edhe në në bodrum:

— Bashkë e kemi këtë ditë,
këtë diell, jemi shokë.»
E dimë që tallen, katilët.
Ne shtrëngojmë grushtin në errësirën e
bodrumit.
Dy botë.

Tarasi kalon celulë më celulë.
Flet Komunizmi. Gjithë vendi merr zjarr.
Zjarr të tillë asnjëherë s'kishte parë.
Fashistët, tradhëtarët, e duan të gjallë.
Po Tarasi nuk kapet.
Se ai është kudo:
në zemrën e ngrohtë të popullit,
në grykën e pushkës së flaktë,
në fjalët e fundit të trimit që ra,
në fjalën e urtë të Partisë. . .

Vdekja ka ikur, ka frikë.
Ne vdesim si pranvera që ikën.
Ne vdesim
se duan emrin Atdhë të na heqin,
ëndërrat tona të bukura të na i heqin,
të na heqin lirinë nga zemra,
gjuhën, proverbat të na i heqin,
trimërinë e lashtë, besën. . .

Nuk donin të na linin të lirë,
të jetonim
në mes të erës dhe të shiut tonë,
në mes të diellit tonë,
të pinim ujë të kulluar që zbret nga mali,
të rronin ose të vdisnim
në tokën tonë, donim në.
të ëndërronim...

Të varfër, leckamanë, na thanë...
Ne ishim të varfër, po të pasur, —
pasuri ne kishim të ardhmen...

Gjak, djersë, uri, urrejtje, —
vullkani shpërtheu,
bota u përmbys,
e ardhmja erdhi,
ja, siç e kemi këtu,
mes nesh na qesh, gëzohemi...
Atdheu ynë aq i bukur dhe pjellor!
Atdheu ynë i lirë,
vaditet me diellin e ideve të komunizmit.
Toka e varfër bëhet e pasur.
Djersa nxjerr bukën.
Zogjtë këndojnë.
Një ditë ecën,

të tjera i shkojnë pas.
Kur populli qesh
do të thotë se ecën drejt,
ndaj balli ynë është më i lartë se Tomorri,
më i bardhë.

Ndaj pushkën s'e lëshojmë, në emër
të pranverave.
Ajo gjithnjë flet,
se ecim akoma në mes të furtunave dhe
erërave.

ISH VITI 1936

Ish viti 1936.

U takuam në një qytet së bashku pesë shokë.

Donim të digjnim botën e vjetër.

Ëndërr e bukur!

Kur shikonim sytë e shokut,

s'kishim nevojë për ditën e diellit,

rrugën e gjenim njësoj,

të gjatë, të bukur,

por edhe të shtrëmbër e me gjëmbe,

po fundi na dilte përpara,

si ëndërra jonë e bardhë.

Ne bisedonim fjalë të ndaluara

me ata që flinin dhe ëndërronin,

me ata që vdiqën

dhe me ata që nuk kishin lindur akoma,

por që në i njihnim,
se për ata
ne kishim ndërruar emrat tanë me furtunën,
me vetëtimën,
me zjarrin dhe me flakën.

ATY BRENDA

Në shtëpinë e ulët, buzë rrugës, —
ku kalonin këmbë të qeta,
të shqetësuar,
këngë që vraponin pa ditur përse,
këmbë që mbanin këpucë me gozhda,
këmbë që qëllonin të burgosurit
pse donin t'u rrëmbenin
të rrahurat e zëmrës për Atdheun,
për të varfërit,
për të ardhmen, —
aty brenda në mësuam të këndonim për
të gjithë,
të ndërtonim për të gjithë.
Era na godiste sytë,
nata që për ne shok i pandarë,
ne rrojtëm,
ca ranë
që të shkruanin historinë e vërtetë
të popullit.


Ç'KËRKONIM NE?

Ç'kërkonim ne?
Të na linin të lirë
që të jetonim
në mes të plisave dhe të ugareve tona,
të mbanim emrat tanë,
të shikonim ëndërrat tona,
të bisedonim me varfërinë tonë,
me trimërinë tonë,
me të ardhmen
që do ta sillnim ne,
se me zhurmën e pushkës
ne matnim luftën tonë.
Po,
sytë e analfabetëve
kënduan shkronjën e parë të çlirimit.

REVOLUCIONI U DHA SY TË BUKUR NJERËZVE

S'kishin ç'të na bënin.
S'kanë ç'të na bëjnë,
se këtu era, zjarri, rrezet e diellit
dhe të hënës,
na njohin, na kanë parë.
Flamuri ynë ka qenë zjarri,
vetëtima,
shkrepëtima.
Ky është gjithnjë flamuri ynë.
Sa herë flisnim,
dilte nga goja jonë e hidhur,
emri i popullit që vuante.
Sa herë flasim,
del nga goja jonë e ëmbël,
emri i popullit që qesh.

Revolucioni u dha sy të bukur njerëzve.



14729

QË AHERE...

Rrugët ilegale na tretën këmbët.
Në këtë rrugë fluturonin ëndërrat tona,
fluturonin si dallëndyshet
dhe ne,
nuk dinim ç'të bënim nga gëzimi,
lanim duart në dritën e mëngjezit
dhe natën
flinim së bashku me rrezet e hënës.
Dielli na hapte derën
kur hynim fshehurazi në shtëpi.

Që ahere ne dinim
me ç'gurë
do të ndërtonim shtëpinë tonë.

PO, TË GJITHA MË KUJTOHEN

Po, të gjitha më kujtohen.
Ne ndërronim çatinë me qiellin,
ndërronim zemrën me botën,
me ata që ndërronin shtratin e tyre me
të ardhmen,
urrenim ata
që donin t'i vinin kufi
zjarrit që dilte nga gjokset tona...
Kur në tryezë nuk kishim bukë,
mendnim fëmijët e zbathur
që rriteshin në mes të fjalëve «kam uri».

Po, të gjitha më kujtohen.

NE NUK KTHEHEMI

Ne nuk kthehemi.
Kështu thoshnim
ahere kur s'duhesh të ktheheshim,
si tani,
si gjithmonë.
Sytë tanë shikojnë përpara.
Edhe po të vdesin,
nuk kthehen.
Dhe nuk duam të vdesim.
Mund të vdesim,
por vetëm duke shikuar përpara,
duke shikuar lart,
duke shikuar larg,
me sytë e të tjerëve,
me sytë e atyreve
që do të lindin e do të rrojnë,
që do të vazhdojnë rrugën tonë.
Ne nuk kthehemi.

NËPËR AGIME

Sapo del agimi
gjaku më rjedh në artere,
ashtu si flakët që nuk shuhen kurrë.
Natën nuk e dua.
Një agim të gjatë do të doja
dhe një fjalë të ëmbël
dhe fjalët e fundit
të Shyqyri Ishmit përpara litarit,
t'i dëgjoja.

TË TJERA SHPRESA

Agimi qeshte dhe malet zgjoheshin,
ahere ne
ngrinim flamurin e kuq të qindisur
me plumba
dhe shpresat tona afroheshin.
Ecnim, ecnim,
na njohu toka jonë, zemra e tokës.
Opingat tona prej lëkure
i arnonim me dëborë,
i lidhnim me gjalm
të tjerur nga vetëtima e maleve,
që e mirrnim në dorë
dhe digjnim me të
sytë e armiqve,
zembrën e armiqve,
rrugën e armiqve.
Kur s'kishim plumba
pushkën tonë e mbushnim me drejtësi
dhe me urrejtje.

NE JEMI RRËNJËT E TIJ

Donte të ishte i lirë si valët e detit.
Nuk e lanë. I lëshuan vdekjen e tërbuar,
po në zemrën e tij
ai kish furtunat e vendit të tij,
fuqia e gjithë popullit ish mbledhur te ai,
gjithë ngrohtësia e diellit, shpejtësia e erës,
fluturimi i shqiponjave,
frymëmarrja e foshnjës së porsalindur,
i rrinin pranë
edhe duart e plakave që dridheshin,
edhe aroma e luleve i jipte krahë,
edhe aroma e plisave,
edhe padrejtësia në zemrat e të varfërve...

Ai ra si lisi shekullor.
Ne jemi rrënjët e tij.
Ai është me ne, në frymëmarrjen tonë,
ai na mban për dore kur kërcejmë,

kur ndërtojmë, na sjell edhe ai gurë,
themelet e shtëpisë i vëmë bashkë,
me të festojmë përvejtorin e çetës,
me të punojmë tokën dhe mbjellim grurë,
metë ecim rrugës kur shkojmë në punë,
vështirësitë e fitoret me të i ndajmë...

Edhe pas vdekjes,
ai kudo është me ne,
me të së bashku,
siç e vëndosëm,
në mbledhjen e celulës në Nëndor..

PËR ATA QË VUAJNË NË BOTË

Vuajnë akoma.

Në botë ka të pasur dhe të varfër.

Të bardhë, të zinj, të verdhë

vdesin nga uria rrugëve të zbrazura.

Veshin për rroba lëkurën e tyre.

Ka fëmijë me sy të thellë,

që në zëmër mbajnë yje të zjarrtë,

po treten e shuhen se s'kanë të hanë.

Deri kur, deri kur do të jetë kështu?

Ta shkulum nga rrënja varfërinë.

Të shtypurit, nga malli

për të parë botën pa uri dhe pa lotë,

në zjarr u hodhën, u tretën.

Në mes më vunë.

Me ta u treta dhe unë.

ME ATË ËNDËRR

Kalonim rrugës duke menduar,
internacionalen këndonim lehtë.
Ëndërra jonë larg fluturonte,
ngjitej në qiell,
grushte i jepte botës së vjetër
dhe shpejt e shpejt
merrte në dorë një copë diell
dhe shpejt ndërtonte
një botë tjetër.

B A B A I T

Era, tramundana, suferina,
të ftohtit, dielli i nxehtë,
të njohën mirë, baba.
Po më mirë të njohu uria
dhe dhembjet e mia.

PO TË DËGJOJ, NËNË, THIRR...

Shkëmb i fortë, rrëpirë.
Në mes cfaka, rigojë,
gjëmbe, hithëra, ribë dhe djersë,
djersë që derdhte nëna ime
duke mbledhur radhiqe.
Një ditë i ngeci opinga dhe ra.
Bëri ah,
mallkoi jetën e rëndë
dhe ahu i saj
arriti edhe tek unë.
Sytë i kish të mavijosur,
zembrën e kish të bardhë,
shpresat i kish të kuqe.
Edhe tani e dëgjoj që thotë:
Ec drejt,
edhe mbi gjëmbe, po të jetë, bir.
Po të dëgjoj, o nënë, thirr...

MOS MË PREK

Mos më prek plagën e vjetër
Më dhemb.
Është e vjetër sa jeta ime.
Në fytyrë nuk duket më.
Plaga rri thellë, s'e sheh dot.

Mos më prek.
Jam i tëri zjarr,
shpresa, dëshira që shtohen.
Mos më prek plagën e vjetër.
Me plagën çaj përpara,
thith dritën, thith ajrin,
po s'ngopem,
se kohën e shkuar e kalova bodrumeve.

TI QESH AKOMA

M. Tutulani

Toka sot
djeg më shumë se kurrë.
Aty ku re lule të kuqe mbinë.
Dielli shikon edhe çuditet,
ç'po ngjet atje poshtë mbi dhë.

Një yll u shkëput atë ditë korriku.
Partia e pa dhe sytë nguli atje.
Margarita e mbajti ballin lartë
dhe thirri:

«O popull, ja ku më ke!»

Të gjithë u ngritën:

«Dëgjoni ç'fjalë thotë,
me ç'zjarr e besim për të ardhmen tonë.»

Dhe plumbat i ranë
mbi trupin e njomë.

Heshtni dhe dëgjoni fjalët që tha.
Fjalë që thuhën vetëm një herë në jetë.

E vranë.

Bashkë me të vranë dhe vëllanë.
Po ato çaste një valë e madhe u ngrit.

Atë ditë unë isha në Tiranë.
Në një shtëpi përdhese të Vasos punëtor.
Fjala erdhi edhe këtu brenda.
E çuam grushtin lart,
 madhështor.

M'u kujtua dita kur u ndamë,
kur sërish, do të shihemi, thamë,
të lirë, pa syze dhe kasqetë.

Ti qesh akoma.
Ti qesh, vërtetë.
Ti qesh se qeshim ne,
Margaritë.

NDJENJA PARTIZANE

U përshëndetëm Taqi, ditën e fundit.
Akoma më duket se të shoh
aq të sigurtë,
aq të qetë,
se ti shkoje drejt vdekjes lavdiplote,
që do të lëshonte pas një dritë të bardhë.

Qeshe dhe dorën më shtrëngove.
Opingat e tua
shkelën edhe një herë mbi kalldrëmin,
mbi atë kalldrëm
që akoma kur e shoh,
më duket se kalon, Taqi, ti. . .

Qeshe dhe dorën më shtrëngove.
I gëzuar se bëje detyrën tënde.
Të vranë.
Po ti, shok, u bëre atë ditë,
shoku ynë më i dashur.

ZËRAT E DIKURSHËM

Zërat e dikurshëm
në oborrin e shtëpisë shtruar me kalldrëm,
në mbrëmjet e shqetësuara të verës,
më duket se dëgjoj...

Oh, atëhere.

Atëhere rronim si milingonat.

Nëna më jepte një dorë dashuri

dhe unë ngopesha.

Shënjat e atyre plagëve i kam edhe tani.

NJË KUJTIM

Isha i vogël.
Në prëhërin e nënës qaja.
S'kisha ç'të haja.
Ajo më puthi.
Kanë kaluar shumë vjet.
Ajo e puthura me aq ëmbëlsi,
hyri në vargjet e mia.

DITA SA GJITHË JETA U ZGJAT

Para shtëpisë së vjetër qëndrova përsëri.
Njëzet e tetë vjet kanë kaluar.
Në mbledhje ilegale
ndënjëm gjithë atë natë.
U ndamë për një ditë.
Po, ah, Sadik,
dita pafund u zgjat. . .

Sadik Stavileci, Heroi i Popullit.

SHQIPËRIA

Ja, Shqipëria u ngrit më këmbë.
I thanë ulu, shplodhu, tha:
Ulur kam qënë gjithë jetën,
ulur, po jo përrulur.
Ngrihej dhe binte, përsëri ngrihej,
deri sa u ngrit që të mos ulet,
toka ime, Shqipëria,
ku të parët e mi më thonë dhe unë i dëgjoj:
Më këmbë,
si malet. . .
Këtu linda unë.

GJER VONË

Në shtrat jam shtrirë.
Zë nuk dëgjohet këtë natë.
Në koridor herë-herë kalon,
infirmierja vetë,
lehtë...
Hap derën, kokën zgjat.
Dhe kur më sheh
mbyll derën shpejt,
lehtë, infirmierja...

Mesnatë. Mendoj.
Një herë,
një copë bukë ndamë bashkë,
njësoj të dy.
E hëngrëm.
Dhe vështronim
njëri-tjetrin
në sy.

Një copë bukë ndamë bashkë.
Në dhëmbin e prishur na mbeti.
Ky që ushqimi ynë përgjithmonë,
gjer vonë.

UDHA E MBARË, BIR

Udha e mbarë, bir.
Në Çermë, në atë tokë të shtrënjtë,
ku, gjatë shekujve
me ahe dhe uhe u mbulua,
ti djersën tënde derdh,
me vrull, me zjarr,
me hov
të gjallë.
Po të tregoj, Jordan.

Këtu,
fëmijët, qëkur lindnin,
kishin
motër të pandarë urinë
dhe ëndërr, o Jordan, kishin lirinë.

Toka u nda.
Dhe unë atë ditë,
bashkë me ta, si një vëlla,
tokën e ndamë me litar.

Më poshtë shko. Këneta s'është më.
Tërbufi, q'u mbush me lotë,
tokë pjellore u bë...

LETËR NGA JONUFRI

Irena ime, letrën tënde e mora...
Vjen erë det dhe mal dhe djerës e dhë.
Ti nuk e di sa herë unë
kam shkelur shkurreve atje...
Atje ku ti po ngre taraca,
sa herë, bija ime,
me ëndërrat e mia shpresëplota,
që zjenin posi zgjua,
ndërtoja ëndërrat e tua.

Jonufri sot nuk është i qetë.
Shkëmbënjtë shkojnë në det.
Me sytë larg,
ne po shikojmë ditët e bardha
që po na vijnë varg...

Do vijë dita kur në Jonufër
pyje hardhish edhe ullinjsh do të ketë,

verë dhe vaj si det.
Zëmra ma do të dehem atë ditë,
të prehem nën hijen e ullinjve,
valët e detit t'i dëgjoj
dhe të këndoj. . . .

Në buzë të detit
shtëpi me shumë kate do të ndërtohen.
Valët bregdetin tonë
me përkëdhelje do ta lagin
dhe njerëzit, si në koshere,
rrugën e tyre s'do ta ndalin.

Ec, o rini!
Ne ty ta japim
zjarrin e zëmrës sonë. . .

NË DETIN JON

Det i kaltërt

që nuk ngopem duke e parë.

Rri, më thonë malet që shikojnë,

Rri, më thonë portokalet,

vreshtat, lulet.

Rri, më thonë dhe thëllëzat që këndojnë.

Rri, më thonë vashëzat me sy bojë deti.

Rri...

EDHE MË...

Edhe më. Edhe më shtrëngoj grushtet,
për të gjetur akoma fuqi,
drita s'më shterron në sy.
Rrugën do ta shpie gjer në fund.
Ka vetëm një rrugë!

LOTËT E NËNËS

Shkisnin faqeve të rudhura, lotët.
Nëna qante dhe kur s'derdhte lotë.
Lotët binin në tokë dhe toka thahej.
Toka thahej edhe kur sytë e nënës e shikonin.
Pemët, kur kalonte, ulnin degët.
Lulet fishkeshin, se u vinte keq.
Të gjithëve u vinte keq.
Vetëm kur e shikoja unë
nëna jetonte çaste lumturie.
Nuk më fliste,
vetëm m'i ngulte sytë që më hynin në zemër.

FJALË TË BARDHA

Persës

Pse dridhesh

kur të duket

sikur

në sytë e mi vjen nata?

Kur zëri im stonon?

E di se gjithmonë,

e di — ta them edhe një herë —,

ti rron kudo me mua,

edhe kur unë mungoj,

edhe kur unë ëndërroj,

se fjalët që thua,

më ngjajnë mua.

Fjalë të bardha, fjalë të bardha...

Sa shumë i dua.

Vetëm fjalë të bardha nxjerr goja jote.

Duam

zërin e tre zogjve të dëgjojmë,
prandaj do të rrojmë.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
1941 (poemë)	3
Ish viti 1936	13
Aty brënda	15
Ç'kërkoni ne?	16
Revolucioni u dha sy të bukur njerëzve	17
Që ahere	18
Po, të gjitha më kujtohen	19
Ne nuk kthehemi	20
Nëpër agime	21
Të tjera shpresa	22
Në jemi rrënjët e tij	23
Për ata që vuajnë në botë	25
Me atë ëndërr	26
Babait	27
Po të dëgjoj, nënë, thirr	28
Mos më prek	29
Ti qesh akoma	30
Ndjenja partizane	32
Zërat e dikurshëm	33
Një kujtim	34
Dita sa gjithë jeta u zgjat	35
Shqipëria.	36
Gjer vonë	37
Udha e mbarë bir	39
Letër nga Jonufri	41
Në detin Jon	43
Edhe më	44
Lotët e nënës	45
Fjalë të bardha	46